

# **RAPORT**

## **I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për programin e Studimit**

**“Master Profesional në Menaxhim Biznesi**

**me Prof Menaxhim i Turizmit”**

**Në Universtetin Mesdhetar të Shqipërisë,**

**Universitet Jo-Publik në Vend**

**Grupi i Ekspertëve të Jashtëm**

**Prof. Dr. Vjollca BAKIU**

**Kryetar**

# Hyrje

Grupi i akreditimit, duke u bazuar ne dokumentacionet perkatese të Universitetit Mesdhetar, jo publik, te Fakultetit te Shkencave Ekonomike per studimet ne programet master Profesional ne Menaxhim Biznesi, konstatoi se organizimi i tij behej sipas drejtimeve te meposhtme:

- MENAXHIM TURIZMI
- MENAXHIM I PASURISE SE PALUATSHME
- MENAXHIM I ARTIT
- MENAXHIM I SHENDETIT
- MENAXHIM I ARSIMIT

Zbatimi i ketyre programeve ishte ne juridiksionin e Departamentit te Menaxhimit, ku pergjegjesi i departamentit ishte edhe autoriteti i programit Master ne Menaxim Biznesi, duke kryer funksionin e kujdestarise per studentet e ketij cikli. Organizimi i ketij programi behej sipas rregullave te percaktuara ne perputhje me kriteret e Kartës së Bolonjës.

Paraprakisht pasi u krijua një grup pune nga Agjencia e Akreditimit te Arsimit te Larte për vlersimin e ketyre programeve mësimore, dhe ne bashkepunim me Universitetin, Fakultetin, apo edhe me Departamentin perkates, grupi i punes hartoi një program pune për procesin e vlerësimit, duke realizuar aktivitetet e meposhtme prane Fakultetit të Shkencave Ekonomike, ne Departamentin e Menazhimit:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe me pergjegjesin e Departamentit te Menazhimit
- Takim me grupin e Vlersimit, duke bere pyetje dhe diskutime me ta.
- Takim me stafin akademik (efektiv dhe me kontrate) per programet e studimit ne nivelin master profesional.
- Takim dhe vizita ne sekretarine mesimore, ne zyren e burimeve njerzore dhe ne zyren e kurrikulave.
- Vezhgim i mjediseve (auditoreve, laboratoreve, bibliotekes dhe sherbimeve per studentet, etj)
- Takim dhe intervista me studentet e programit perkates, « Menaxhim i Turizmit »
- Takim permbylles me titullarin e institucionit.

Gjatë punës, grupi i vlerësimit ka mbajtur lidhje të vazhdueshme dhe ka patur ndihmën e të gjithë pedagogëve të Fakultetit të Shkencave te Ekonomisë, Rektorit, njekohesisht dhe Dekan i ketij Fakulteti, si dhe te të gjithë stafit ndihmës të Universitetit.

## Përbërja e GVJ

Grupi i punes perbehej njekohesisht nga eksperte te fushes se ekonomise, si dhe te Menaxhimit te Turizmit, sipas perberjes se meposhtme:

- Prof. Dr. Vjollca BAKIU , Kryetar (eksperte e fushes se Ekonomise, Marketingut dhe Turizmit )
- Prof. Dr. Lavdosh ZAHO, Anetar, (ekspert i fushes se Ekonomise, Finances dhe Bankave)
- Prof. As.Dr. Manjola NAÇO, Anetare (eksperte e fushes se Ekonomise dhe Kontabilitetit)
- Dr. Arjan QEFALIA, Anetar, (ekspert i fushes se Ekonomise dhe Menaxhimit te Biznesit)

## Parimet e Punës së GVJ

Grupi i punes se vlersimit te jashtem, per programin *Master Profesional ne Menaxhim Biznesi me profiling Menaxhim i Turizmit*, gjate punes se tij u mbeshtet kryesisht ne:

- Besimin e krijuar gjate prezantimeve te punes per zbatimin e ketij programi, qofte nga titullari Universitetit, Fakultetit perkates, qofte ne ate te bere nga stafi akademik apo ai ndihmes, si dhe ne mendimin e shprehur edhe nga studentet.
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga Grupi i Punes te Vetvlersimit te Brendeshem, prane Institucionit perkates, si dhe dokumenta te ndryshme te kerkuara nga grupi i punes per verifikime te mundeshme te bera gjate punes, dokumenta te cilat u vune ne dispozicion te grupit pa hezitim, etj.
- Ne vezhgimet e bera sipas vizitave te organizuara ne ambjentet e formimit profesional te studenteve sipas programit perkates, prane ketij Institucioni, etj.

## **Të dhëna për programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me Profil Menaxhim i Turizmit”**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë pas akreditimit nga Këshilli i Akreditimit dhe licensimit nga MASH, gjatë muajit nëntor 2011, organizon programet e studimit Master shkencor dhe Master profesional, për të mundësuar arsim dhe kualifikim të mëtëjshëm për kategori të ndryshme profesionistësh.

<b>Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardet shtëtorë për programet e studimit të Ciklit të Dytë</b>	
<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit<sup>1</sup></b>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1</b>	
<b>- Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Misioni i</b> Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit.	
<b>Qëllimi i</b> Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është ndërtimi i një komuniteti mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Studentë apo profesionistët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë, kanë të drejtë të ndjekin studimet Master në programin: Master profesional në Menaxhim Biznesi (60 ECTS) me drejtime: Menaxhim i turizmit Menaxhim i pasurisë së paluajtshme Menaxhim i artit

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	<p>Menaxhim i shëndetit</p> <p>Menaxhim i arsimit</p> <p>Te akredituara nga Këshilli i Akreditimit dhe te licensuara nga MASH, gjatë muajit nëntor te vitit 2011.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë në të gjitha drejtimet përfshi këtu edhe profilin e Menaxhimit të Turizmit, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 ECTS kredi në përputhje me Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p>	<p>Formimi i studenteve në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë behet sipas qëllimit dhe misionit të tij qe eshte te përgatisë specialistë të aftë në fushat e shkencave ekonomike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, shkencave politike dhe administratës publike.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Programet e studimit në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë janë hartuar në mënyrë të tillë që ti përgjigjen nevojave te tregut te punës në vend, në rajon e më gjerë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë synon që nëpërmjet zhvillimit të procesit mësimor të programit të ciklit të dytë Master Profesional në menaxhim Turizmi te pajisë studentët me njohuri për formimin e tyre si menaxherë të ardhshëm te turizmit.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p>	<p>Ky institucion i arsimit të lartë i përgjigjet nevojave të vendit, duke qene ne kohezion me zhvillimin dhe progresin ekonomik i tij. Për këtë arsye edhe programet e studimit të ofruara nga ky Universitet, te cilat i takojnë fushës ekonomike, duken ne perputhje me kete zhvillimin, pasi ai është një nga qëllimet kryesore të të gjithë shoqërisë.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profilin Menaxhim i Turizmit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të vendit.</p> <p>UMSH me politikat dhe strategjitë e saj si dhe me programet e studimit mbajnë parasysh nevojat imediate dhe ato ne perspektive të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit si ne kontekstin rajonal të Shqipërisë ashtu edhe në kontekstin mesdhetar. Kjo materializohet ne tre aspekte kryesore të zhvillimeve mesdhetare:</p> <p>Zhvillimet dhe proceset integruese ekonomike;</p>

	Zhvillimet dhe proceset gjeopolitike dhe kulturore; Marrëdhëniet midis vendeve të Mesdheut në kontekstin e proceseve dhe marrëdhënieve globale.
<b>Konkluzione:</b>	
Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara, si rrjedhim edhe <b>Standardi I.1</b>	
<b>Standardi I.2</b> - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit që organizohet në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, duke mbartur në vetevetë përmirësime të vazhdueshme të tij, dihet që me evoluimin e tregut duhet të evoluojë edhe ky program studimi.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike me shumë në aspektin e menaxhimit të një biznesi në teresi, se sa në aspektin e mirëfilltë turistik, duke lënë për të dëshiruar në aspektin e trajnimit profesional në fushën e turizmit.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Programi Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit synon të zgjerojë njohuritë e përfutuara nga studentët në ciklin e parë të studimeve.
<b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ( në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;	

<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit; ka si qellim formimin e eksperteve dhe specialisteve te mirefillte ne fushen e menaxhimit te biznesit te turizmit por formimi teorik dhe kryesisht ai profesional i studenteve behen ne drejtim te strategjive te marketingut, te menaxhimit strategjik; te menaxhimit te sistemeve te informacionit ne fushen perkatese dhe te menaxhimit te projekteve, nderkohe qe ka nevojte me teper per kulture te mirefillte turistike ne kete drejtim.</p>
<p><b>Konkluzione:</b></p> <p>Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem te programit te studimit Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret deri diku jane te plotesuara per <b>Standardin 1.2</b>, duke mbartur me vete mundesine e disa ndryshimeve te nevojshme per formimim me specifik, pra me profesional turistik te studenteve te ketij niveli.</p>	
<p><b>Standardi I.3</b> - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Në hartimin dhe implementimin e programit të studimit Master Profesional të UMSH ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit janë plotësuar të gjitha parakushtet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin për arsimin universitar (Ligji i Arsimit të Lartë Nr.9741, datë 21.5.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010 dhe Udhëzimet përkatëse të MASH).</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Emërtimi i programit “Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit” respekton emërtimin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b></p> <p>Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem te programit te studimit Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret jane te plotesuara per <b>Standardin 1.3</b>.</p>	
<p><b>Standardi I.4</b> - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.</p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Programi Master Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i turizmit synon përgatitjen e specialistëve me kualifikimin e nevojshëm në fushen e turizmit. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimit te ofruar.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve të studentëve në UMSH bëhet nëpërmjet provimeve të kombinuara, me shkrim dhe me gojë. Provimet përmbajnë teste të formave të ndryshme, të cilat kontrollojnë jo thjesht dijet e fituara, por aftësitë arsyetuese, argumentuese dhe kritike të studentëve.</p> <p>Sipas Rregullores së UMSH-së, neni 15, sistemi i vlerësimit të njohurive të studentëve në Universitetin “Mesdhetar” është me 10 nota. Nota më e ulët për kalim është 5.</p> <p>Format e kontrollit të njohurive të lëndëve (provimet) mund të bëhen:</p> <p>a) me shkrim,  b) me gojë,  c) i kombinuar, me shkrim e me gojë.</p> <p>Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, miratuar nga Rektori pas marrjes së mendimit të Dekanit. Grafiku i provimeve propozohet nga përgjegjësit e kurseve të studimit dhe shpallen jo më vonë se një javë para fillimit të sezonit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b>  Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin I.4.</b></p>	
<p><b>Standardi I.5</b>  <b>- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane</p>	<p>Programi e studimit të ciklit të dytë Master Profesional Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetet deri diku në përvojën dhe praktikën vendeve evropiane të cilat janë të shquara për traditën e gjatë universitare dhe nivelin e lartë të universiteteve të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është i një niveli të mirë, pothuaj me të gjithë elementët përbërës duke e bërë atë deri diku ndërkombëtarisht konkurrues, të njohur dhe të vlerësuar duke afirmuar dhe forcuar vlerat më të mira të</p>

universitar në Shqipëri;	arsimit universitar shqiptar.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programi i studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit janë hartuar në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Programi i studimit të ciklit të dytë master Profesional është i akredituar edhe i njohur nga Ministria e Arsimit të Sllovenisë, një vend anëtar i BE dhe ndjek e zbaton të gjitha politikatat e unionit.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret deri diku janë të plotësuara për <b>Standardin I.5</b> , duke mbartur mundësinë e adaptimit me programet me të mira evropiane për të ardhmen.	
<b>Standardi I.6</b> <b>- Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit përfshijnë aftësimin profesional në fushën e administrimit të biznesit me profilin e menaxhimit të turizmit, duke përfshirë në vetvete mundësinë e kërkimeve shkencore për të ardhmen.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Programi i ciklit të dytë Master profesional në Menaxhim Biznesi i profilizuar në drejtimin Menaxhim i turizmit, është hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim të metejshëm.
<b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Sipas dokumentacioneve të paraqitura nga UMSH, personeli akademik i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë zhvillon punën kërkimore shkencore nëpërmjet punimeve të ndryshme shkencore, të cilat prezantohen në konferenca të organizuara nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë si dhe në konferenca të zhvilluara nga institucione të tjera kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit.
<b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Punimet kërkimore shkencore e personelit akademik të Universitetit botohen në revistën shkencore të UMSH, Euromediterranean si dhe në revista të tjera prestigjioze shkencore në Shqipëri dhe jashtë. Puna kërkimore shkencore është në shërbim të realizimit të programeve të studimeve. Ajo është në shërbim dhe përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të programit të studimit.



<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin 1.6.</b></p>	
<p><b>Standardi I.7</b> <b>- Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Programi e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit është hartuar deri diku në mënyrë të tillë që ti përgjigjet nevojave që paraqet tregu i punës në vend, në rajon dhe më gjerë.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i turizmit ka si qëllim formimin e eksperteve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të biznesit të turizmit, por formimi teorik dhe kryesisht ai profesional i studentëve bëhet në fushën e strategjive të marketingut, menaxhimit strategjik; menaxhimit të sistemeve të informacionit; të menaxhimit të projekteve, etj, pa patur formim specifik në fushën e turizmit. Tregu i punës në Shqipëri, rajon dhe më gjerë tregon se ka nevojë për specialist në fushën e mësipërme dhe kjo bën që të diplomuarit të kenë mundësi të gjejnë vehten të koordinuar saktë në tregun e punës.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë deri diku të plotësuara për <b>Standardin 1.7.</b> duke mbartur mundësinë e përmirësimit të tyre për të ardhmen me qëllim adaptimin me të mirë të tyre me problemet e sektorit turistik në vend.</p>	
<p><b>Standardi I.8</b> <b>- Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p>Programi i studimit të UMSH në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit merr parasysh interesat kombëtare të vendit në fushën ekonomike, pra nevojën për specialiste dhe menaxher të turizmit, por formimi i tyre në fushën përkatëse le për të deshiruar.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</li> <li>- kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të</li> </ul>	<p>UMSH kryen studim tregu për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</li> <li>- kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> </ul>

<p>regjistrohen në këtë program;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet si motra.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet si motra.</li> </ul>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë deri diku të plotësuara për <b>Standardin 1.8.</b></p>	
<p><b>Standardi I.9</b> <b>- Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p>	<p>Ne baze të vezhgimeve të bëra, Institucioni ofron programin e studimit përkatës i cili nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ne baze të vezhgimeve të bëra, programi i studimit përkatës synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin 1.9.</b></p>	
<p><b>Standardi I.10</b> <b>- Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Ne baze të verifikimeve të bëra nga grupi i punës, për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit UMSH përdor metodologjinë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsulta me trupën akademike, ekspertë të jashtëm dhe student.</li> <li>- Krahasim me ecurinë e programeve të ngjashme të studimeve në Universitetet e tjera të vendit dhe të huaja.</li> </ul> <p>Për vlerësimin e ecurisë së programit të studimeve UMSH përdor instrumentat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorë të strukturuar që përfshijnë pyetje konceptuale; me studentë që ndjekin programin e studimit me të diplomuar; me pedagogë, ekspertë dhe punëdhënës të cilët përfshijnë vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, dhe të mësuarit;</li> <li>- Intervista;</li> <li>- Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>- Dëgjime në auditor;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Ne baze të verifikimeve të bera nga grupi i punës konstatohet se UMSH e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë së punës së tij.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Ne baze të dokumentacionit perkates, UMSH ka programuar publikimin e rezultateve të pritshme gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2011-2012.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>- Pyetje konceptuale;</li> <li>- Intervista;</li> <li>- Etj.</li> </ul> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>- Dëgjime në auditor;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>- Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj.</li> </ul>	<p>Ne baze të dokumentacionit perkates të vezhguar nga grupi i punës, UMSH për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>- Pyetje konceptuale;</li> <li>- Intervista;</li> <li>- etj.</li> </ul> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>- Dëgjime në auditor;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>- Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>- Etj.</li> </ul> <p>Elementë të formave të mësipërme janë përdorur dhe janë parashikuar të aplikohen në vlerësimet e pritshme.</p>

<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin I.10.</b></p>	
<p><b>Standardi I.11</b> - <b>Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Ne baze të verifikimeve të bëra grupi i punës konstatoi se UMSH bazuar në përpunimin e të dhënave të mbledhura, duhet të hartojë një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit perkates.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>UMSH në të njëjtën mënyrë duhet të hartojë edhe një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë deri diku të plotësuara për <b>Standardin I.11.</b> dhe për të cilin lihet detyrë për plotësim për një të ardhme të shpejtë.</p>	
<p><b>Standardi I.12</b> - <b>Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master profesional në Menaxhim Biznesi me drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <u>Menaxhim i turizmit</u></li> <li>- Menaxhim i pasurisë së paluajtshme</li> <li>- Menaxhim i artit</li> <li>- Menaxhim i shëndetit</li> <li>- Menaxhim i arsimit</li> </ul> <p>përmban 60 ECTS dhe zgjat 1 vit akademik, në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteri është i plotësuar për <b>Standardin I.12.</b></p>	
<p><b>Standardi I.13</b> <b>- Institucioni publikon rregullisht informacion të pa-anshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Nga verifikimet e bera grupi i punës konstatoi se UMSH duhet të bëjë botimin e materialeve informuese në ndihmë dhe në mbështetje të vlerësimit të brendshëm, të cilat do të bëhën të njohura studentëve, pedagogëve, ekspertëve dhe kolegëve të universiteteve të tjera publike dhe private dhe ekspertëve të tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Materialet informuese në ndihmë dhe mbështetje të vlerësimit të brendshëm, të cilat u adresohen studentëve, pedagogëve dhe ekspertëve të arsimit universitar dhe të tregut të punës, duhet të prezantohen në faqen zyrtare të UMSH.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë deri diku të plotësuara dhe krejtësisht të realizueshme në një të ardhme të afërme me qëllim plotësimin e <b>Standardit I.13.</b></p>	
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</b></p>	
<p><b>Standardi II.1</b> - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p>	<p>Nga takimet e bera të grupit të punës me personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë konstatoi se ata angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve. Cdo punonjës ka përshkrimin e tij të punës, i cili mban parasysh këto kërkesa.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Detyrat specifike përcaktohen në përshkrimin e punës, të mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e UMSH-së.</p>

<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin II.1.</b></p>	
<p><b>Standardi II.2</b> <b>- Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p>	<p><b>Misioni i</b> Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit. <b>Qëllimi i</b> Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është ndërtimi i një komuniteti mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p>	<p>Ne bazë të dokumentacionit perkates qe ju vu ne dispozicion grupit te punes u konstatua se UMSH fillimisht ka hapur tri njësi kryesore, nga të cilat tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë dhe Fakulteti i Shkencave Politike. Në vitin akademik 2010-2011 UMSH riorganizoi Fakultetin e Shkencave Politike në Fakultetin i Shkencave Politike dhe Administratës Publike. Ky riorganizim u bë duke u nisur nga rrethanat e mëposhteme: Ndryshimi i ligjit për arsimin e lartë dhe kërkesa e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të pasqyruar këto ndryshime në strukturën, programet dhe nivelet e studimit në universitetet publike e private; Nevoja e një sinergjime me të mirë në përgatitjen e specialistëve të shkencave politike të destinuar për jetën, marrëdhëniet, institucionet dhe proceset politike si edhe specialistëve të destinuar për administratën publike; Nevoja e përgjigjes (dhe paraprirjes) së nevojave të tregut për specialiste të mirëfillte, të përgatitur posaçërisht për tu punësuar në administratën publike, në nivelin qendror dhe vendor.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p>	<p>Njësi kryesore në UMSH janë fakultetet: •Fakulteti i Shkencave Ekonomike •Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administrative</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Fakulteti i Marredhenieve Nderkombetare dhe Diplomacise</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p>	<p>Njësi kryesore në UMSH janë fakultetet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Fakulteti i Shkencave Ekonomike</li> <li>•Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administrative</li> <li>•Fakulteti i Marredhenieve Nderkombetare dhe Diplomacise</li> </ul> <p>Departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit konsiderohen njësi bazë. Në UMSH çdo fakultet përbëhet nga së paku 2 departamente dhe një qendër e cila është e përbashkët në këtë stad të zhvillimit të UMSH.</p> <p>Për Fakultetin e Shkencave Ekonomike, njësitë bazë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet</li> <li>Departamenti i Menaxhimit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Ne baze te verifikimit te bere Kriteri 5 ishte i pa plotesuar</p>
<p><b>Konkluzione:</b></p> <p>Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret jo teresisht jane te plotesuara per <b>Standardin II.2.</b>, keshtu qe lihet si detyre qe ne perspektiven e afert te plotesohen ato.</p>	
<p><b>Standardi II.3</b> - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Në mbështetje të Statutit dhe Regullores së UMSH, (neni 27 dhe 28 i Statutit ) Departamentet dhe Fakultetet e UMSH angazhohen drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë aktive në realizimin e programeve të studimeve, nëpërmjet përfshirjes edhe të pedagogëve përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në mbështetje të nenit 36 dhe 37 të Statutit si dhe Regullores së UMSH, Departamentet dhe Fakultetet e UMSH angazhohen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij, nëpërmjet përfshirjes edhe të pedagogëve përkatës.</p>

<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin II.3.</b>	
<b>Standardi II.4</b> <b>- Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Nga verifikimet e bëra të grupit të punës, konstatohet se të gjitha kurrikulat e UMSH janë hartuara nga personeli akademik i UMSH, duke përfshirë pedagogët me kohë të plotë dhe pedagogët me kohë të pjesshme.
<b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Në rekrutimin e personelit të ri dhe përcaktimin e ngarkesës mësimore janë respektuar dhe respektohen kërkesat dhe standartet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë Nr.9741, datë 21.5.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010; Udhëzimet e MASH; nenet 36 dhe 37 të Statutit dhe Rregullorja e Universitetit neni 27 që rregullojnë rekrutimet dhe ngarkesën)
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin II.4.</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	UMSH e zhvillon aktivitetin e vet në një godinë të marrë me qera, të pajisur me hapësirat, infrastrukturën, shërbimet dhe standartet e nevojshme për zhvillimin në kushte mjaft cilësore të mësimi dhe kërkimit shkencor
<b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës Kontrata e qerasë është nënshkruar për një periudhë dhjetëvjeçare
<b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Mesimdhënia dhe aktivitetet e tjera të UMSH-së në të gjitha programet e studimit ofrohen në një godinë të vetme.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	--



<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret jane te plotesuara per <b>Standardin II.5.</b></p>	
<p><b>Standardi II.6</b> <b>- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Nga verifikimet e bera, grupi i punes konstatoi se të gjitha programet e studimeve, modulet dhe syllabuset janë hartuar nga pedagogët e UMSH, në bashkëpunim, në konsultim dhe duke marrë parasysh verejtjet dhe sugjerimet e studentëve dhe janë në cdo kohë të aksesueshëm prej tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë publikuar në formë broshurash dhe u ofrohen studentëve në formë elektronike.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret jane te plotesuara per <b>Standardin II.6.</b></p>	
<p><b>Standardi II.7</b> <b>- Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>Sipas verifikimit te bere, grupi i punes konstatoi se UMSH ka programuar ta kryejë analizën vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë në muajin korrik 2012.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Politikat dhe masat e UMSH-së për përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsultimin e vazhdueshëm me programet analoge të universiteteve të njohura perendimore</li> <li>• Konsultimin e vazhdueshëm me programet analoge të universiteteve publike dhe private të njohura në vend</li> <li>• Konsulta me ekspertë të huaj arsimit universitar dhe parauniversitar</li> <li>• Konsulta me ekspertë të arsimit universitar dhe parauniversitar në Shqipëri</li> <li>• Konsulta me studentë</li> <li>• Konsulta me politikë-bërës dhe mnenaxherë të sistemit arsimor universitar</li> <li>• Konsulta me ekspertë të tregut të punës.</li> </ul>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me siper, grupi i punes per vlersimin e jashtem të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret jane deri diku te plotesuara per <b>Standardin II.7.</b> me detyre per permbyshje te tyre te plote per te ardhmen e shpejte.</p>	

<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Nga bisedat me studentet dhe personelin akademik grupi i punës konstatoi se me fillimin e semestrit të fundit të secilit prej programeve Master Profesional hartohet individualisht nga çdo student në bashkëpunim me drejtuesin e zgjedhur prej tij, një plan diplomimi i cili përcakton periudhat kohore dhe angazhimet e duhura për diplomimin.
<b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteri është i plotësuar për <b>Standardin II.8.</b>	
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Bazuar në detyrimin ligjor UMSH bën auditim të jashtëm të përvitshëm të situatës financiare të tij. Auditimi kryhet nga studio AIEI Auditors.
<b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Nga verifikimet e bera, në raportin e auditit të kryer nga AIEI Auditors përmbahet një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë.
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Në raportin e auditit të kryer nga AIEI Auditors paraqitet dhe analizohet efica e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin II.9.</b>	
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMOR SHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.</b>	
<b>Standardi III.1</b> <b>- Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Nga verifikimi i dokumentacioneve perkatese grupi i punës konstatoi se UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p>	<p>Nga verifikimi i bërë, u konstatua se personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë nuk përbën 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Nga verifikimet e bëra nga grupi i punës u vërejt se UMSH synon të realizojë misionin, vizionin dhe objektivat e programeve të studimit: duke rekrutuar pedagogë me kohë të plotë, në përputhje dhe në plotësim të nevojave të mësim-dhënies në këtë institucion;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• duke rekrutuar pedagogë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, në përputhje me standartet e caktuara për raportin midis numrit të studentëve dhe pedagogëve;</li> <li>• duke përfshirë në personelin mësimor, shkencor dhe edukativ si edhe në trupën e pedagogëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe me kohë të pjesshme personalitete nga më të njohurit të fushave përkatëse;</li> <li>• duke u kujdesur për ndërthurjen e potencialeve, burimeve dhe personaliteteve të njohura e të vlerësuara në nivel kombëtar me personaliteteve të njohura ndërkombëtarisht;</li> <li>• duke harmonizuar rekrutimin e personaliteteve dhe profesorëve me përvojë të gjatë akademike e kërkimore-shkencore me prurjet e reja premtuese.</li> </ul> <p>Sipas Statutit të UMSH-së, neni 36, 37 personeli i Universitetit “Mesdhetar” të Shqipërisë përbëhet nga shtetas shqiptarë ose të huaj, të cilët grupohen, sipas profilit të punës, në kategoritë e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Personeli mësimor shkencor (akademik);</li> <li>b) Personeli ndihmës (teknik) mësimor shkencor;</li> <li>c) Personeli administrativ;</li> <li>d) Personeli i shërbimit.</li> </ol> <p>Përzgjedhja e personelit për vendet e punës për personelin e kategorisë (a) e (b) bëhet nëpërmjet shqyrtimit të kandidatëve nga një komision i përbërë nga Rektori, Administratori dhe një përfaqësues i Qendrës. Kontrata e punësimit nënshkruhet nga Rektori. Procedurat e punësimit të personelit të kategorive (c) dhe (d) përcaktohen me vendim të Administratorit.</p>

<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Nga grupi i punës u verifikua se Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Rekrutimit pranë UMSH mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret nuk janë të plotësuara teresisht për <b>Standardin III.1.</b> , për të cilin grupi i punës le detyre të plotësimin sa më të shpejtë të tyre.	
<b>Standardi III.2</b> <b>- Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i Programeve Master në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë ka gradën PHD të fituar në Universitet e huaja dhe përvojë akademike në këto Universitete.
<b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;
<b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve Master Profesional ka gradën shkencore “Doktor”.
<b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Në përputhje me nenin 24, 25, 26, 27, të Statutit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve.
<b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Stafi i angazhuar pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë plotëson kërkesat për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin III.2.</b>	
<b>Standardi III.3</b> <b>- Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Nga verifikimi i bere mbi baze të dokumentacioneve perkatëse u konstatua se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë organizon

	veprimtari akademike në funksion të programeve Master që organizon me qëllim përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore, seminare, konferenca për të rritur nivelin e cilësisë. Materialet e dala nga këto aktivitete publikohen si në revistën shkencore të Universitetit ashtu edhe në rjetet ndërkombëtare ku UMSH është anëtarësuar (EMUNI, EURAS)
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Mendohet se përfshirja e personelit akademik që do të udhëheqë studentët gjatë punës praktike dhe tezës do të shërbejë si kontribut në zhvillimin e shkencës dhe të sektorëve të prodhimit në fushat përkatëse.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin III.3.</b>	
<b>Standardi III.4</b> <b>- Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikate për njohje të avancuar të saj;	Mendohet se: Në mënyrë që studentëve të programeve Master tu ofrohen eksperiencat më të mira ndërkombëtare UMSH do të organizojë leksione publike apo module të vecanta brenda lëndës me personel akademik të ftuar, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që UMSH ka me Universitete ndërkombëtare.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Në mënyrë që studentëve të programeve Master tu ofrohen eksperiencat më të mira ndërkombëtare UMSH do të organizojë leksione publike apo module të vecanta brenda lëndës me personel akademik të ftuar, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që UMSH ka me Universitete ndërkombëtare.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë pritje për tu plotësuar për <b>Standardin III.4.</b>	
<b>Standardi III.5</b> <b>- Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Nga verifikimi i bere si dhe nga bisedat me studente dhe personel akademik konstatohet se me fillimin e semestrit të fundit të programit Master Profesional hartohet individualisht nga çdo student në bashkëpunim me udhëheqësin e zgjedhur prej tij, një plan diplomimi i cili

	përcakton periudhat kohore dhe angazhimet e duhura për diplomimin.
<b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Udhëheqësi i temës ka gradën shkencore “Doktor”.
<b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Nga bisedat me personelin akademik, UMSH në përcaktimin e udhëheqësve të temave, periudhë kjo që parashikohet të jetë rreth muajit korrik 2012, mendon se do ti përmbahet standardeve shtetërore të cilësisë të cilat parashikojnë që Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin III.5.</b>	
<b>Standardi III.6</b> <b>- Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Mendohet se fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.
<b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar e sipër <b>Standardin III.6.</b>	
<b>Standardi III.7</b> <b>- Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Programet e studimit master Profesional që organizohen në UMSH nuk kanë në përbërjen e tyre orë të cilat duhet të zhvillohen në laboratorë, por duke qenë se UMSH ka në dispozicion ambiente dhe infrastrukturën e duhur, në programe të tjera studimi mund të realizohen edhe orët laboratorike.

<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UMSH dëshmon për një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin III.7.</b></p>	
<p><b>Standardi III.8</b> <b>- Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në përputhje me Ligji i Arsimit të Lartë Nr.9741, datë 21.5.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010; Udhëzimet e MASH; nenet 36 dhe 37 të Statutit dhe Rregullorja e Universitetit nëni 27 që rregullojnë rekrutimet dhe ngarkesën.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimit të ciklit të dytë si dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin III.8.</b></p>	
<p><b>Standardi III.9</b> <b>- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>UMSH disponon një bazë të hollësishme të dhënash të përbërë prej dosjesh të detajuara për të gjithë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programe studimit si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Këto të dhëna administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore të UMSH.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore pranë UMSH disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor shkencor dhe atij administrative.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Sipas nevojave të UMSH-së, shpallet konkursi dhe kryhet publikimi i njoftimit "Për shpalljen e vendeve të lira të punës për personelin akademik". Gjithashtu, merren masat për publikimin e këtyre njoftimeve edhe në gazeta, revista apo televizione sipas mundësive/fondeve të universitetit. Domosdoshmërisht njoftimet duhet të publikohen në faqen zyrtare të universitetit së</p>

	<p>bashku me formularët e aplikimit.</p> <p>Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin III.9.</b></p>	
<p><b>Standardi III.10</b> <b>- Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p>	<p>Sipas bisedave me stafin akademik, UMSH nxit kualifikimin shkencor dhe profesional të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë, nëpërmjet formave të mëposhtme: Pjesëmarrja e pedagogëve dhe punonjësve shkencorë në zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore, të financuara nga UMSH; Nxitjen e pjesëmarrjes së pedagogëve dhe punonjësve shkencorë në zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore të financuara nga universitete dhe institucione të tjera; Financimin e pjesëmarrjes së pedagogëve dhe punonjësve shkencorë në udhëtime studimore në universitete dhe institucione të huaja; Financimin e botimeve të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë nga UMSH Press ose ente të tjera botuese, brenda dhe jashtë vendit;</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtijshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Sipas drejtuesve të UMSH, institucioni përkates organizon në sesionet verore kualifikimet e pedagogëve dhe të punonjësve shkencorë, sipas tematikave të caktuara.</p> <p>Rezultatet dhe përvoja e kualifikimit shkencor dhe profesional të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë të UMSH pasqyrohet në përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit dhe përmbajtjes së lëndëve.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin III.10.</b></p>	
<p><b>Standardi III.11</b> <b>- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Sipas verifikimeve të bëra, UMSH disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë</p>



	program studimi
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	UMSH disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
<b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	UMSH disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin III.11.</b>	
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1</b> <b>- Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që pranohen në Programet e studimeve Master Profesional pranë UMSH janë të detyruar të kenë në zotërim të paktën diploma universitare Bachelor dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS. Në Statutin dhe Rregulloren e UMSH janë përcaktuar procedurat dhe kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional. Kriteret dhe procedurat janë hartuar bazuar në Ligji i Arsimit të Lartë Nr.9741, datë 21.5.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010; Udhëzimet e MASH 11, 14, 33, 45, etj; nenet 28/2 dhe 31 të Statutit dhe Rregullorja e Universitetit neni 20, 21, 22.
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;
<b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;
<b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e	Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e

<p>integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>UMSH vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin IV.1.</b></p>	
<p><b>Standardi IV. 2</b> <b>- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Sipas bisedave me studentët, atyre ju jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në UMSH është ngritur dhe funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës ka disa funksione kryesore: Informimi i studentëve e ardhshëm (maturantët aplikantë) për programet e studimeve që ofron UMSH dhe kërkesat, politikat dhe standartet e pranimit; Këshillimi i studentëve të UMSH-së që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, në UMSH ose universitete të tjera, të vendit dhe të huaja; Këshillimi i studentëve të UMSH-së që diplomohen në nivelin e parë dhe të dytë për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si edhe mundësitë e punësimit në tregjet rajonale dhe më gjerë. Dhënia e informacionit për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga UMSH.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për</p>	

<p>programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin IV.2.</b></p>	
<p><b>Standardi IV. 3</b>  <b>- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>UMSH pret të diplomojë brezin e parë në vitin akademik 2011-2012</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>Nga verifikimi I bere sekretaria mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin master profesional të studimit perkates të ciklit të dytë, për tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Sekretaria Mësimore dhe Pranimet, disponojnë të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim</p>
<p><b>Konkluzione:</b>  Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin IV.3.</b></p>	
<p><b>Standardi IV. 4</b>  <b>- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë pret të diplomojë brezin e parë në fund të vitit akademik 2011-2012</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë do të mbajë një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>
<p><b>Konkluzione:</b>  Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar e sipër për <b>Standardin IV.4.</b></p>	
<p><b>Standardi IV. 5</b>  <b>- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>	<p>Sekretaria Mësimore dhe Pranimet informon studentët në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit</p>

<b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Sekretaria Mësimore dhe Pranimet informojnë studentët për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.
<b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin IV.5.</b>	
<b>Standardi IV. 6</b> <b>- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Në UMSH është ngritur dhe funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës ka disa funksione kryesore: Informimi i studentëve e ardhshëm (maturantët aplikantë) për programet e studimeve që ofron UMSH dhe kërkesat, politikat dhe standartet e pranimit, etj Këshillimi i studentëve të UMSH-së që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, në UMSH ose universitete të tjera, të vendit dhe të huaja; Këshillimi i studentëve të UMSH-së që diplomohen në nivelin e parë dhe të dytë për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si edhe mundësitë e punësimit në tregjet rajonale dhe më gjerë.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra e Këshillimit të Karrierës ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët, UMSH ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi efektiv me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmendim, bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës Aleancën e Biznesit të Kosovës Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë Shoqatën e Bankave të Shqipërisë
<b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin IV.6.</b>	
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1</b> <b>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>Nga verifikimi i bere ne biblioteken e UMSH, u konstatua se institucioni ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë, e cila është vendosur dhe sistemuar në Bibliotekën e UMSH. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në katin e parë të godinës së Universitetit dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studjuesit.</p> <p>Në Rregulloren e UMSH-së, neni 9, sanksionohet se Biblioteka është njësi ndihmëse në shërbim të departamenteve, varet nga Administratori dhe kryen këto detyra: administron dhe dokumenton fondin e librave të Universitetit; administron dhe dokumenton fondin e librave të studentit; administron shërbimin e internetit për studentët.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>UMSH ka siguruar një literaturë të mire, në ndihmë të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë. Biblioteka e UMSH përbëhet nga:</p> <p>Përkthime të teksteve bazë të autorëve klasikë të shkencave ekonomike, politike, administrative dhe mërrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Përkthimet e teksteve bazë të autorëve më të njohur bashkëkohorë të të shkencave ekonomike, politike, administrative dhe mërrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Botime të autorëve më të njohur shqiptarë në fushën e shkencave të shkencave ekonomike, politike, administrative dhe mërrëdhënieve ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Biblioteka e UMSH krijon mundësi që studentët të kërkojnë literaturën e nevojshme në rrugë elektronike.</p> <p>Biblioteka e UMSH porosit botime reja në rrugë elektronike, nga <i>wwwbsite-t</i> e njohura të tregëtimit të botimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, UMSH alokon cdo vit një fond prej rreth 500,000 ALL.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Oraret e punës të Bibliotekës së UMSH shpallen në hollin e katit të parë dhe në hyrje të Bibliotekës.</p>

<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin V.1.</b></p>	
<p><b>Standardi V. 2</b> - <b>Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Nga verifikimi i bërë në mjediset e UMSH janë në dispozicion të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të UMSH kjo bazë logjistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 20 numri i PC për studentët</li> <li>▪ 1 laborator me PC për studentët</li> <li>▪ 9 numri i PC për stafin akademik</li> <li>▪ 4 numri PC për administratën</li> <li>▪ 1 printer kombinat stacionar rrjeti dhe 2 lokal</li> <li>▪ 1 fotokopje kombinat stacionare rrjeti</li> <li>▪ 5 numri i videoprojektorëve</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Pajisjet e të gjitha mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie dhe në përputhje me të gjitha standardet e cilësisë brenda hapësirës evropiane të arsimit të lartë.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Të gjithë laboratorët e UMSH përmbajnë aparaturat më bashkëkohore dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>UMSH vendos në dispozicion të studentëve laboratorin e PC.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin V.2.</b></p>	
<p><b>Standardi V. 3</b> - <b>Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë,</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të punës, në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët e programeve Master Profesional, UMSH ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi efektiv me</p>

<p>industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p>	<p>përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmendim, bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës Aleancën e Biznesit të Kosovës Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë Shoqatën e Bankave të Shqipërisë</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin V.3.</b></p>	
<p><b>VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE</b></p>	
<p><b>Standardi VI.1</b> <b>- Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p>	<p>UMSH ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në bilancin financiar të audituar nga AIEI Auditors për vitet 2009-2010 dhe 2010-2011.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>UMSH dëshmon garancitë e nevojshme financiare në llogaritë e veta bankare.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin VI.1.</b></p>	
<p><b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENSHME DHE TË JASHTME</b></p>	
<p><b>Standardi VII.1</b> <b>- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>Sipas bisedave me stafin, UMSH vazhdimisht nxit bashkëpunimin e frytshëm dhe produktiv ndërmjet personelit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit,</p>	<p>UMSH kujdeset për mbarëvajtjen e një marrëdhënieje të frytshme bashkëpunimi</p>

<p>marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>ndërmjet personelit.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Nga sa me sipër, grupi i punës për vlersimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin VII.1.</b></p>	
<p><b>Standardi VII.2</b> <b>- Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të punës, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në bashkëpunim me njësitë e veta funksionale kryen studimin e tregut ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar duke mundësuar dhe financuar pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme akademik Brenda dhe jashtë vendit, anëtarë të personelit të tij akademik. Disa nga Universitetet partnere të UMSH janë:</p> <p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut. Si anëtar i këtij rrjeti, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është në marrëdhënie dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare si Université Montpellier I, Montpellier, France, Université Paris-Est, Paris, France, Université de la Méditerranée-Aix Marseille-II, Marseille, France, University of Westminster, London, UK, Polytechnic University of Valencia (UPV), Valencia, Spain, University of Trieste, Trieste, Italy, University of Palermo, Palermo, Italy, University of Porto, Porto, Portugal, Aristotle University of Thessaloniki, Thessaloniki, Greece, etj.</p> <p>AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS – MAQEDONI UNIVERSITETI ILIRIA – KOSOVË KOLGJI I BIZNESIT – KOSOVË UNIVERSITETI AYDIN ISTAMBOLLIT –</p>



	<p>TURQI  UNIVERSITETI KRISTIAN DIMITRIE  CANTEMIR – RUMANI  UNIVERSITETI I QIPROS – QIPRO  UNIVERSITETI VUZF I SOFIES –  BULLGARI  UNIVERSITETI I MOSTARIT – BOSNJE  DHE HERCEGOVINË  UNIVERSITETI I TUZLËS – BOSNJE  HERCEGOVINË  UNIVERSITETI I SARAJEVËS – BOSNJE  HERCEGOVINË  UNIVERSITETI MEDITERAN I  PODGORICËS – MAL I ZI</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët, UMSH ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi efektiv me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmendim, bashkëpunimin me:  Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës  Aleancën e Biznesit të Kosovës  Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë  Shoqatën e Bankave të Shqipërisë</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>UMSH ka ne plan organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UMSH ka ne plan të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>
<p><b>Konkluzione:</b>  Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuar për <b>Standardin VII.2</b>, dhe mbartin mundësinë e perfeksionit të tyre në të ardhmen.</p>	
<p><b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b></p>	
<p><b>Standardi VIII.1</b>  <b>- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Sipas bisedave me stafin akademik, kontrolli i brendshëm i mësimdhënies kryhet nga specialistë të Njësisë së Sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave. Ky kontroll konsiston në drejtim të ruajtjes së korrektësisë në oraret e mësimit, duke pasur për bazë filozofinë e gjithë Universitetit që thekson “shenjtërinë” e orës mësimore. Rezultatet e kontrolleve të orëve mësimore, bëhen objekt</p>

	<p>diskutimesh në mbledhjet e departamenteve ku nxirren përfundime apo marren masat për të korrigjuar aspektet problematike të punës. Përveç kësaj strukture, një peshë të madhe në kontrollin e mësimdhënies, zënë edhe vlerësimet që japin studentët në përfundim të çdo lënde. Këto anketime kryhen para provimit, nga persona të paanshëm (jo vetë pedagogët) dhe përpunohen nga Dega Mësimore dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe analizohen arsyet e rezultateve pozitive dhe negative, duke u munduar që të shkëmbehen eksperiencat pozitive dhe të minimizohen ato negative.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	<p>Në mbështetje të Rregullores së UMSH-së nxitja dhe përmirësimi i performancës së mësimdhënies realizohet nga Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave, si një strukturë e posacme e UMSH e cila funksionon në përputhje me standardet e vendosura nga APPAL dhe ENQA.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave kryen këto funksione:  Vlerëson periodikisht çdo semester efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe praktikave profesionale, provimet me shkrim, si dhe në raste të veçanta për kurse të veçanta.  Ndjek procesin e mësimdhënies dhe evidenton praktikat më të mira si edhe praktikat e këqija;  I propozon Shefit të Departamentit masat përkatëse për promovimin e praktikave më të mira si edhe shmangien e praktikave të këqija;  Propozon organizimin e sesioneve kualifikuese për pedagogët me performancë të ulët.</p> <p>Materialet e vlerësimit periodik të Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave i kalojnë Rektorit dhe Bordit të Universitetit.</p> <p>Vlerësimet me shkrim të kontrolleve periodike të cilësisë për mësimdhënien shqyrtohen në një nga mbledhjet e Senatit të UMSH-së dhe vendimet për përmirësimin e gjëndjes merren në Senat.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	<p>Sipas dokumentacionit perkates, materialet e vlerësimit periodik të Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të curriculave i kalojnë Rektorit dhe Bordit të</p>

	<p>Universitetit.</p> <p>Vlerësimet me shkrim të kontrolleve periodike të cilësisë për mësimdhënien shqyrtohen në një nga mbledhjet e Senatit të UMSH-së dhe vendimet për përmirësimin e gjëndjes merren në Senat.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit është i një rëndësie të vecantë dhe për këtë arsye UMSH ndërgjegjëson personelin si edhe studentët për këtë fakt.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UMSH merr masa për vlerësimin e programit të studimit perkates nga treguesit e punësimit të të diplomuarve të secilit program.</p> <p>Vlerësimi i parë i këtij lloji është parashikuar të realizohet në semestrin e parë të vitit akademik 2012-2013, pasi të ketë dalë në treg kursi i të diplomuarve të vitit 2012.</p>
<p><b>Konkluzione:</b></p> <p>Nga sa me sipër, grupi i punës për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit mbështetur në Standardin shtetëror për programet e studimit të Ciklit të Dytë, nxjerr si konkluzion se kriteret janë të plotësuara për <b>Standardin VIII.1.</b></p>	

## Analiza SWOT për Implementimin e Programit të Studimit

### Pikat e forta

- Kushte të mira infrastrukturore
- Staf i mirë administrativ
- Stafi i kualifikuar akademik

### Pikat e dobëta

- Programi i studimit, jo në përputhje të plotë me titullin e tij “Menaxhim i Turizmit”
- Mungese e numrit të pershtatshëm të Stafit të brendshëm, me kulturën e nevojshme turistike

### Kërcënimet

- Mungese e numrit të studentëve për ecuri normale të institucionit
- Cilësi jo fort e mirë e prurjes së studentëve
- Vlersime shumë pozitive të studentëve

### Oportunitetet

- Përpjekje e institucionit për të mbajtur dhe inkurajuar standardet
- Përpjekje për përmirësim të programeve dhe curriculave në mënyrë të vazhdueshme

- Mundesi te Institucionit per te fituar imazh poziv ne treg

### **Rekomandimet**

- Permiresime te shpejta te programeve mesimore per t'ju pershtatur zhvillimit ekonomik dhe turistik te vendit
- Permiresim i kurrikulave per perputhjen e diplomes me emrin perkates
- Shtim apo zevendesim i disa prej tyre per ti sherbyer formimit te mirfillte te menaxhimit turistik
- Nevoja per Staf te brendeshem apo te jashtem, ose edhe me staf me statusin e te ftuarit, por te pergatitur ne fushen e Menaxhimit te Turizmit.
- Te plotesohen kriteret sipas konkluzineve perkatese per çdo standard, te shkruar ne raport.

Nisur nga sa me siper i rekomandojmë APAAL<sub>it</sub> dhe KA<sub>së</sub> që institucionit te arsimit të lartë jo publik: “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)”, t’i jepet akreditimi i nevojshem për programin e studimit “Master Profesional ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Turizmit“.

### **Grupi i Ekspertëve të Jashtëm**

**Prof. Dr. Vjollca BAKIU**

**Kryetar**

Tirane, 2012